



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:062121

Datë: 16.05.2019

Numri i dokumentit: 00314090

**P. nr.823/18**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm**, Gjyqtarja **Ilijana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit B. M. nga Gjakova, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.3 lidhur me par.1-1.4 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore-DP në Gjakovë, PP.nr.1497/18 të datës 20.11.2018, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datë **08.05.2019**, në prani të Prokurorit të shtetit Mone Syla ,përf. ligjor i të dëmtuarës G. M. të dëmtuarës- të miturës L. M.dhe të akuzuarit B. M., të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa përpiloj me dt. 15.05.2019 këtë:

### **A K T G J Y K I M**

I akuzuari **B. M.**, nga Gjakova , Rr. ”. . .“ p.n , i biri Z. dhe i nënës Gj. e gjinisë P. , data e lindjes . . .,në Deçan, ka të kryer shkollën e mesme , i pa punë ,e gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar ,shtetas i R. Kosovës, i martuar atë i 3 fëmijëve , ID . . .

### **Ë s h t ë f a j t o r :**

#### **Sepse:**

- **me dt.08.10.2018, rreth orës 19.00h**, në shtëpinë e tyre të përbashkët në Gjakovë , i shkakton lëndime të lehta personit tjetër të dëmtuarës-të miturës vajzës së tij L. M., në atë mënyrë që pasi e dëmtuara kishte hyrë në debat në lidhje me një raste që kishte ndodhur para një muaji e gjysmë , ku i pandehuri-babai i saj kërkonte sqarime shtesë lidhur me rastin e që e dëmtuara – e mitura nuk dinte të sqaronte më shumë , i pandehuri –babai i saj e godet me shuplaka në fytyrë dhe me shkelmë në trup me ç ‘rast të dëmtuarës – të miturës i shkakton lëndime të lehta trupore , të konstatuara sipas akt ekspertimit mjeko-ligjor të Dr. F. S. D. të dt. 31.10.2018.

-**me çka ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 3lidhur me par.1 nënparg.1.4 të KPRK-së .**

Andaj ,Gjykata konform nenit 4, 41, 49, 50, 51, 52, 73,74,75 ,82 dhe nenit 188/3-1-1.4 të KPRK-së ,si dhe nenit 365 të KPPK-se ,të akuzuarit i shqipton ,

### **DËNIM ME KUSHT**

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej **7(shtatë ) muajve**, i cili dënim nuk do te ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës se verifikimit në afatin prej **1(një) viti**, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

I akuzuari obligohet që të paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 20,00 € në emër të ekspertizës mjeko-ligjore si dhe në emër të paushallit gjyqësor në shumë prej 20.00 €, në afat prej 15 ditëve, pasi që Aktgjykimi të merr formë të prerë, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

**Mbikëqyrjen e periudhës verifikuese te dënimit me kusht do ta bënë Shërbimi Sprovues i Kosovës Dega në Gjakovë .**

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjakovë, ka ngritur aktakuzën PP.nr.1497/18 të datës 20.11.2018 ndaj te akuzuarit B. M.nga Gjakova, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 3 lidhur me par. 4.1 të KPRK-së .

Gjatë shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 08.05.2019, përfaqësuesi i PTH-së në Gjakovë prokurori i shtetit Mone Syla lexon aktakuzën PP.nr.1497/18 të datës 20.11.2018 dhe deklaron se mbetet në tërësi pranë aktakuzës por te kualifikimi i veprës penale për shkak te gabimit te natyrës teknike te konstatuar nga neni 188/3-4.1 duhet te jete 188/3-1-1.4 te KPRK-ës ndërsa pjesa tjetër mbetet e pandryshuar.

I akuzuari B. M. , gjatë shqyrtimit fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë thekson se e pranon ne tërësi fajësinë sipas aktakuzës me te cilën pandehet duke i ditur edhe me pare pasojat e pranimi te fajësisë dhe atë ne mënyrë vullnetare dhe pa presion, se e pranon ne tërësi fajësinë sipas aktakuzës me te cilën pandehet duke i ditur edhe me pare pasojat e pranimi te fajësisë dhe atë ne mënyrë vullnetare dhe pa presion, shtojë se me pranimin e fajësisë ne çdo fazë te procedurës jam penduar pe veprën e kryer ne afekt për shkak te rastit qe i ka ndodhur vajzës time ditën kritike pasi qe unë isha i shqetësuar për rastin qe i kishte ndodhur, nga e njëjta kam kërkuar shqyrtime por e njëjta nuk ishte ne gjendje e as ne dijeni qe te përgjigjet ne pyetjet e parashtruar nga unë për çka edhe sot te njëjtës i kërkojë falje për lëndimin e shkaktuar , premtojë se një veprim i tillë nuk do te përsëritet dhe do te jem me i kujdesshëm, të dëmtuarën – te miturën e kam vajzë dhe për te njëjtën kujdesem dhe do te beje çmos qe e njëjta te tejkalon atë qe ka përjetuar. I propozojë gjykatës qe te merr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë në çdo fazë te procedurës , pendimin e shprehur e gjykatë, premtimin se ne te ardhmen do te jem me i kujdesshëm ,kërkim falja ,gjendjen e dobët ekonomike , si dhe faktin se është hera e parë qe kam ra ndesh me ligjin ,te me shqiptojë një dënim me te butë .

Perf. i ligjor- axha ,G. M. ,deklaroj nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e te akuzuarit , nuk i bashkëngjitëm ndjekjes penale dhe nuk kërkojë kompensim demi me qene se raportet e tyre janë te rregulluara ,i njëjti pas rastit kujdeset ne çdo mënyrë qe e njëjta ta kalon stresin duke e dërguar rregullisht ne Qendrën për Punë Sociale si dhe çdo gjë qe është e nevojshëm për te mirën e këtu te dëmtuarës L. M.te cilën i akuzuari e ka vajzë .

Mbrojtësi i viktimave A. P. deklaroi se pas një konsultimit paraprake me palën e dëmtuar e po ashtu e edhe me perf. ligjor këtu axhën e te dëmtuarës te cilët edhe gjate seancës u deklaruar se nuk e kundërshtojnë pranimin e fajësisë e po ashtu nuk kërkojnë kompensim demi si dhe ndjekjen penale ndaj këtu te akuzuarit për shkak se raporte mes te dëmtuarës dhe kryesit j anë rehabilituar në mase te duhur për çka edhe kryesi i veprës sot gjate seancës u zotuar se do ta shton mbikëqyrjen dhe do te këtë sjellje si prind ndaj vajzës se tij e cila ka qene

viktima e dhunës (pale e dëmtuar ) andaj i propozoi gjykatës që këto të merren për bazë si rrethana lehtësuese gjatë marrjes së vendimit lidhur me këtë rast.

Zyrtarja e shërbimit sociale nga QPS në Gjakovë T. L. U., deklaroi se pas bisedave ,trajtimit dhe konsultimit me të miturën edhe në nuk e kundërshtojmë pranimin e fajësisë pasi që marrëdhëniet prind fëmijë janë rregulluar dhe e njëjta është në gjendje me të mirë pasi që ka kujdesin e shtuar nga prindërit e saj e posaçërisht nga këtu i akuzuari .

E dëmtuara – e mitura L. M. deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk kërkon kompensim demi

Prokurori i shtetit Mone Sylja deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit B. M. pasi që i njëjti pranimin e fajësisë e bënë me vetëdije dhe vullnet të plote dhe pa presion dhe deklaroi se në rastin konkret aktakuza me të gjitha provat e saja që i bashkëngjiten asaj e përbejnë figurën e plote të veprës penale nga neni 188/3-1-1.4 të KPRK-ës dhe shtojë faktin se edhe përkundër faktit se tani këtu i akuzuari ka pranuar fajësinë në rastin e incidentit në fjalë me të miturën është dashur që të njëjtës të ia jep një përkrahje të momentit që me se shumti i është dashur asaj në atë moment e jo ta godas si në rastin konkret edhe përkundër shqetësimeve si prind është dashur të zgjidhë ndryshe problemin për faktin se e mitura edhe ashtu duhet të jete në bazë të ligjit në mbikëqyrje të prindit i cili në atë moment nuk ia ka ofruar ,andaj kërkojmë që i akuzuari të shpallet fajtor , të dënohet sipas ligjit dhe të obligohet në pagesën e shpenzimeve procedurale.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari B. M.: - **me dt.08.10.2018, rreth orës 19.00h**, në shtëpinë e tyre të përbashkët në Gjakovë , i shkakton lëndime të lehta personit tjetër të dëmtuarës-të miturës vajzës së tij L. M., në atë mënyrë që pasi e dëmtuara kishte hyrë në debat në lidhje me një raste që kishte ndodhur para një muaji e gjysmë , ku i pandehuri-babai i saj kërkonte sqarime shtesë lidhur me rastin e që e dëmtuara – e mitura nuk dinte të sqaronte më shumë , i pandehuri – babai i saj e godet me shuplaka në fytyrë dhe me shkelmë në trup me ç ‘rast të dëmtuarës – të miturës i shkakton lëndime të lehta trupore , të konstatuara sipas akt ekspertimit mjeko-ligjor të Dr. F. S. D. të dt. 31.10.2018.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë ,për shkak të se cilës gjykata nuk ka administruar provat ,gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bere në pajtim me nenin 248 të KPPK-ës. Gjate pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë ,pranimi është bere vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet dhe provat që i përmban aktakuza ,në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qarte ligjore ose gabime faktike .

Gjykata nga të cekurat me lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale të përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpalle fajtor dhe ta gjykojë në bazë të ligjit ,me pare duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike të tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPK-së , të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Rrethana rënduese gjykata e konsideron faktin se i akuzuari ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188/ 3-1-1.4 të KPRK-së, ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata

ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: është familjarë, babai i tre fëmijëve sjelljen e tij para kryerjes së veprës penale ka qenë korrekte, qytetar i rëndomtë dhe se asnjëherë nuk ka rëndesh me ligjin dhe nuk ka qenë i dënuar. Në këtë drejtim ka ndikuar veçanërisht personaliteti i tij që te gjykata është kuptuar si njeri i sjellshëm, korrekt, i urtë dhe i vetëdijshëm për pasojat e shkaktuara është penduar thellë për veprën penale të kryer si dhe pas rastit raportet me të dëmtuarën të cilën e ka vajzë janë rregulluar. Ndërsa si rrethana posaçërisht lehtësuese gjykata vlerësoi pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestarë, shprehjen e keq ardhjes për rastin që ka ndodhur , kërkim faljen publike të dëmtuarës, premtimi se një veprim i tillë nuk do të përsëritet dhe faktin se e dëmtuara dhe përf. ligjor i saj nuk i janë bashkangjitur ndjekjes penale dhe nuk kanë kërkuar kompensim dëmi . Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese për të akuzuarin, gjykata ka ardhur në përfundim se në rastin konkret eksitojnë kushtet për zbutjen e dënimit nga neni 75 par.1 nënpar.1.2 të KPP-së , dhe se me dënimin me kusht duke i vërtetuar dënim me burgim në kohë zgjatje prej **7(shtatë )** muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1(një) viti**, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale ,në të cilin dënim në rast të revokimit të dënimit me kusht duhet të iu llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data **09.10.2018 e deri me datën 23.10.2018**, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 dhe 50 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari. Gjykata beson se me shqiptimin e sanksionit të tillë, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në dispozitën e nenit 41 të KPRK-ës, se kjo do të ndikoj tek i akuzuari që në të ardhmen të mos kryejnë vepra penale, si dhe do të ndikoj tek të tjerët në ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit

Gjykata nuk ka vendosur për kërkesë pasurore juridike , ngase e pëf. ligjor e poashtu e dëmtuara – e mitura gjatë shqyrtimit fillestar nuk ka paraqitur kërkesë pasurore juridike.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushalli gjyqësor bazohet në dispozitat e nenit 450 par.1 dhe 2 nën paragrafi 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,  
P. nr.823/18 me datë 08.05.2019.**

**Sekretarja juridike,  
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,  
Ilirjana Hoti**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi mund te paraqitet ankesë, në afatin prej **15 ditësh** ,nga dita e marrjes se tij ne dorëzim ,Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa ne kopje te mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.